



REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.651/12

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në çështjen juridike të paditësit B. H. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, kundër të paditurit R. H. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë vërtetimin e të drejtës së servitutit të kalimit, vlera e kontestit 3100.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt. **25.07.2013**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit B. H. nga fshati ... Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se i njëjti e ka të drejtën e servitutit të kalimit me rrjedhën e ujit të lumit me kanal dhe gypa me kompensim dhe atë nëpërmes pjesës së paluajtshmërisë e shënuar si par.kat.1269, në vendin e quajtur "R. G.", e cila ka sipërfaqen e tërësishme prej 379 m² dhe e cila udhëhiqet sipas listës poseduese ZK R., në kufinjë dhe në masë në pajtim me kopjen e planit të pronarit-mbajtësit R. H. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, ndërsa i urdhërohet të paditurit që paditësit t'i mundësojë shfrytëzimin e qetë të drejtës së servitutit të kalimit nën kërcënim të ekzekutimit me dhunë.

II. SHFUQIZOHET masa e përkohshme e sigurimit e caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.651/12, datë 10.07.2012.

III. OBLIGOHET paditësi që në emër të shpenzimeve procedurale, të paditurit t'i paguaj shumën prej 120,00 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi B. H. në shqyrtimin kryesor deklaroi se mbetet në tërësi pranë të cekurave në padi dhe kërkesëpadi, deklarimeve në shqyrtimet e mbajtura, parashtrësive të dorëzuara në gjykatë. Më tutje ka shtuar se me të paditurin i kanë parcelat fqinje, ku paditësi është pronar i ngastrës kadastrale nr. 1274, në vendin e quajtur "L. G.", në sipërfaqe të tërësishme prej 1255 m² dhe e cila udhëhiqet sipas listës poseduese ZK R., kurse i padituri në bazë të trashëgimisë nga i ati tani i ndjerë S. H. është mbajtës i paluajtshmërisë e cila evidentohet si

parc. kadastrale nr. 1269 në vendin e quajtur "R. g.", e cila ka sipërfaqen e tërësishme prej 379 m² e cila udhëhiqet sipas list. poseduese ZK R. Në këtë kuptim për nevoja të tjera paditësi diku në vitin 1970 e ka ndërtuar kanalën në të cilin i ka vendosur gypat, ashtu që paluajtshmërisë së tij i ka siguruar ujin nga lumi të cilën e shfrytëzon edhe sot. Në pajtim me marrëveshjen e të atit të këtu të paditurit, nga periudha e ndërtimit të kanalit, një pjesë e kanalit dhe gypat kalojnë edhe nga pjesa e paluajtshmërisë me nr. të ngastrës 1269, e cila sot është në posedim të këtu të paditurit. Në këtë mënyrë paditësi e ka fituar të drejtën e servitutit të kalimit me mbajtje, sepse nga koha e ndërtimit të kanalit kanë kaluar më shumë se 20 vite, e as pronari i mëparshëm, e as mbajtësi (këtu i padituri), nuk kanë parashtruar as me shkrim e as ndonjë kundërshtim. Paditësit i takon kjo e drejtë edhe sipas ligjit sepse nuk ka kalim tjetër me të cilën do ta ndërtonte kanalën për rrjedhjen e ujit, e cila është kusht që pompa të punojë pa rrezik. Me datën 26.06.2012, i padituri ka filluar me gropimin në paluajtshmërinë e tij, me të cilin rast e ka prerë kanalën dhe gypat, ashtu që pompa e benzinit ka mbetur pa sasinë e ujit, e që është rrezik si për pompen ashtu edhe për mjedisin. Paditësi i ka tërhequr vërejtjen të paditurit dhe i ka treguar pasojat dhe në këtë kuptim i ka propozuar që kanalën ekzistues dhe gypat ti aftësojë në llogari të vet ashtu që të paditurit të mos i pengojë në shfrytëzimin e qetë të objektit të tij, por i padituri e ka refuzuar dhe ka vazhduar gropimin. Si rrjedhojë ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit dhe vlerësimit të provave kërkesëpadinë e paditësit ta aprovojë në tërësi si të bazuar, si dhe të obligojë të paditurin ti paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizat e kryera.

I padituri R. H. në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të cekurave në shqyrtimet e mbajtura, përmes të cilave e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Më tutje ka theksuar se shfrytëzimin e parcelës së tij nga ana e paditësit me qëllim marrjen e ujit nga lumi i afërt e ka dhënë me vetëdëshirë vetëm për shfrytëzim të përkohshëm, ndërsa këtë të drejtë paditësi e ka keqpërdorur. Kjo për faktin se për mua ka qenë e domosdoshme që të ndërtoj shtëpinë familjare në atë parcelë, ndërsa para fillimit të ndërtimit të saj unë i kam ofruar mundësinë paditësit që gypat e ujit t'i tërheq më lartë ose më posht vendit ku është ndërtuar shtëpia, mirëpo i njëjti nuk ka pranuar. Më tutje ka shtuar se në atë pjesë jetojnë 7 familje dhe secili nga ne ka dalje në lum, ndërsa këtë mundësi e ka edhe paditësi, kurse nuk e ka kontestuar faktin se paditësi ujin e ka shfrytëzuar që 20 vite. Në fjalën e fundit deklaroi se meqenëse paditësi i ka disa alternativa të tjera për të siguruar ujin për pompën e tij, kërkon që kërkesëpadia e tij të refuzohet në tërësi si e pabazuar, ndërsa shpenzimet e procedurës i ka kërkuar për ekspertin e ndërtimtarisë dhe për shpenzimet e veturës së gjykatës.

2. Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. P-71813070-01274-0, dt.07.02.2012, lejën e punës PTP "B. G.", dt. 27.03.2008, çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. P-71813070-01269-0, dt.07.02.2012, ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë L. R. e dt. 10.07.2012, ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë L. M. dt.

10.07.2012, ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë (dega Hidro) G. H. e datës 09.07.2013, ka bërë dëgjimin e ekspertëve të lartcekur në shqyrtimin kryesor.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pabazuar**.

3. Faktet

Nga çertifikata mbi të drejtat pronësore nr. P-71813070-01274-0, dt.07.02.2012, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale e lartpërmendur, është e regjistruar në emër të paditësit B. H. (në të cilën ngastër është e vendosur pompa e bezinës "B. G.").

Nga leja e punës nr. 3782 PTP "B. G.", dt. 27.03.2008, vërtetohet fakti se Komuna e Prizrenit e ka lejuar firmën e lartcekur që të ushtroj aktivitetin e saj për shitjen e derivateve të naftës.

Nga çertifikata mbi të drejtat pronësore nr. P-71813070-01269-0, dt.07.02.2012, gjykata vërtetoi faktin se ngastra kadastrale e lartpërmendur, është e regjistruar në emër të Sezair Hudutit, përndyshe parardhësit të paditurit R. H. (ngastër kjo nëpër të cilën ka kaluar gypi për sjelljen e ujit në ngastrën e paditësit).

Në ekspertizën e ekspertit të gjeodezisë L. R. të dt.10.07.2012, konstatohet se sipas shënimeve me të cilat disponon Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër ngastra kadastrale nr. 1274 me kulturë jopjellore në sipërfaqe prej 12, 55 ari, evidentohet në emër të paditësit B. H. nga fshati R. Komuna e Prizrenit, ndërsa ngastra kadastrale nr. 1269 me kulturë e klasit të 5-të, në sipërfaqe prej 3,79 ari, evidentohet në emër të S. H. nga po i njëjti fshat. Me daljen në vendin e ngjarjes në ngastrat e cekura më lartë është bërë identifikimi i ngastrave të paditësit dhe të paditurit dhe u konstatua se në ngastrën e të paditurit janë duke u zhvilluar punimet ndërtimore, hapja e podrumit dhe betonimi i pllakës së bodrumit, me ç'rast nga ana e të paditurit është bërë ndërprerja e ujit (heqja e gypave) i cili nga Lumbardhi mbi urë ka ardhur me ramje të lirë nëpër gypa nëpër ngastrat 1268, 1269, 1270, 1271, 1273 dhe ka përfunduar në ngastrën e paditësit 1274. Kjo gjendje sipas paditësit është shfrytëzuar që nga viti 1987, ku në atë kohë të gjitha këto ngastra shfrytëzoheshin si toka bujqësore dhe uji ka shërbyer për ujitjen e tyre, ndërsa tani në të gjitha këto ngastra janë të ndërtuara objekte banimi dhe afariste, ku në ngastrën e tij paditësi ka të ndërtuar objektin familjar për banim dhe pompën e benzinës.

Në ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë L. M. të datës 10.07.2012, konstatohet se pas identifikimit të ngastrës të paditurit nr. 1269, u konstatua se në këtë ngastër është duke u ndërtuar objekti familjar për banim, i cili është në fazën e ndërtimit, më saktësisht është betonuar pllaka mbi podrum. Me ndërtimin e objektit, i padituri ka shkëputur nga rrjedha tubin e ujit 100 mm nga PVC dhe ka ndërprerë gypësjellësin nga lumi deri te stacioni i karburantëve në pronësi të paditësit. Nga shiqimi në vend është konstatuar se paditësi e ka

ndërtuar para shumë viteve gypsjellësin i cili ka kaluar nga ngastrat e përmendura më lartë, ndërsa tani i padituri e ka hjekur nga ngastra e tij pjesën e gypave, kurse edhe vet paditësi i ka menjanuar një pjesë të gypave nën urë pasi që ju ka ndërprerë marrja e ujit nga i padituri.

Në ekspertizën e ekspertit të ndërtimtarisë G. H. (inxhinjer i hidros) të datës 09.07.2013, ndër të tjera konstatohet se prurësi i ujit PCV Fi 100 mm duhet të dislokohe nga hapsirat e të paditurit, prurësi-gypi PVC Fi 100 mm i shtrirë nën objektin e të paditurit e destabilizon objektin tij në çdo pikëpamje, pasi që mund të ndodh rrjedhja e ujit nga lidhësat e gypave, apo të ketë ndonjë rregullim tjetër eventuale. Më tutje ka shtuar se gjatë ndërtimit të objekteve ndërtimore, objektet pasurohen me sistemin e drenimit (drenazha) për largimin e ujërave nëntokësore eventuale nga objekti-themelet-për sigurimin e objektit nga destabilizimi prej ujërave nëntokësore, ndërsa ky është standard i ndërtimtarisë respektivisht Hidrondërtimtarisë. Nëse ekziston ndonjë zgjidhje teknike (Alternativa Tekniko-teknologjike për zgjidhjen e problemit) duhet të aplikohet pa marr parasysh koston-vlerën e punimeve kur janë në pyetje dy subjekte me prona private individuale. Në rastin e paditësit ekziston mundësia tekniko-teknologjike e zgjidhjes për ndërtimin e prurësit për transportimin e ujit nga vendi i marrjes te lumi Manastiricë, deri te puseta ekzistuese (prona e paditësit në ngastrën kadastrale 1274 vendi “L. G.”, pa prekur pronën e të paditurit, më saktësisht ngastra kadastrale 1269 në vendin e quajtur “R. G.”. Sipas situatës dhe konfiguracionit ekzistues në lokalitet, ekzistojnë kushtet tekniko-teknologjike i zgjidhjes së problemit me ujë për paditësin në disa varianta pa shkaktuara pengesa pronësore-juridike dhe teknike. Më tutje ka cekur se si mënyrë e parë për të siguruar ujin është kalimi me BY PASS pa prekur pronën e të paditurit edhe nga ana e jugut kah rruga Prizren-Reqan, edhe nga veriu kah lumi Lumbardh. Si mënyrë e dytë për të sjellë ujin në pronën e paditësit është që prurësi prej kyqjes te lumi Manastiricë deri te puseta ekzistuese te prona e paditësit të shtrihet paralelisht me lumin e Lumbardhit në anën e majtë, jashtë koritës së lumit në pronën publike, ndërsa si mënyrë të tretë ka cekur marrjen e ujit nga lumi i Lumbardhit të bëhet në pronën e paditësit (nën livadhin ekzistues që është pronë e paditësit. Në fund ka cekur se në këtë rast ekziston mundësia tekniko-teknologjike e zgjidhjes së furnizimit me ujë pa brenga në kushte ekzistuese natyrale, ndërsa është e drejta e paditësit që të zgjedhë variantin më të favorshëm (më gjerësisht referoju ekspertizës dhe deklarimeve të ekspertit të bëra në shqyrtimin kryesor).

4. Ligji i aplikueshëm

Ligji Nr. 03/L-154 mbi Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDS, i cili ligj ka hyrë në fuqi me datë 20.08.2009), më saktësisht neni 252 thotë: “1. Servituti sendor është e drejta e pronarit përkatës të një paluajtshmërie (paluajtshmëria dominuese) që një paluajtshmeri tjetër (paluajtshmëria shërbyese) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë apo të ndaloj kryerjen e veprimi të caktuar ose të përjashtoj ushtrimin e së drejtës së caktuar, të cila rrjedhin nga e drejta e pronësisë në paluajtshmerinë shërbyese. 2. Servituti sendor duhet t’i siguroj ndonjë dobi titullarit të servitutit, përndryshe servituti është i palejuar. 3. Një servitut sendor nuk mund ta detyrojë pronarin e paluajtshmërisë shërbyese për një veprim”. Ndërsa neni 253 flet për krijimi i servitutit sendor dhe atë: “1. Servituti sendor krijohet në bazë të një punë juridike, një vendimi të organit shtetëror ose një

ligji. 2. Për krijimin e një servituti sendor sipas punës juridike është e nevojshme një kontratë dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë. Me kontratë palët duhet të merren vesh, për krijimin dhe përmbajtjen e servitutit. 3. Dispozitat në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni do të zbatohen në të gjitha rastet përveç nëse me vendim administrativ ose me ligj të veçant parashihet ndryshe”. Më tutje neni 254 i po këtij ligji flet për ushtrimin e arsyeshëm i të servitutit sendor dhe atë: “1. Titullari i të drejtës së servitutit sendor duhet ta ushtron servitutin në atë mënyrë, që pasurisë së paluajtshme shërbyese ti paraqes ngarkesën më të vogël të mundshme. 2. Gjatë ushtrimit të një servituti, titullari i servitutit i ruan në mënyrë adekuate edhe interesat e pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar, derisa nuk cenohet ushtrimi i servitutit”...

5. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat i kemi cekur më lartë, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar në ligj dhe fakte. Gjykatës i rezultoi se pretendimi i paditësit për të vërtetuar të drejtën e servitutit të kalimit me rrjedhen e ujit të lumit me kanal dhe gypa nëpërmjet pronës së paditësit e evidentuar si ngastër kadastrale 1269, është i pabazuar dhe për këto arsye e njëjta u desh të refuzohet.

Nga provat e administruara, por edhe nga pohimi i palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se paditësi para shumë viteve (mbi 20 vite) e kishte ndërtuar kanalën në të cilin i ka vendosur gypat PVC Fi 100 mm, të cilët kanë sjellur ujin nga lumi Lumbardh, ndërsa mbi urë ka ardhur me ramje të lirë nëpër gypa nëpër ngastrat 1268, 1269, 1270, 1271, 1273 dhe ka përfunduar në ngastrën e paditësit 1274. Ndërsa sipas deklarimit të paditësit ky kanal është shfrytëzuar që nga viti 1987, pasi që në atë kohë të gjitha këto ngastra shfrytëzoheshin si toka bujqësore dhe uji ka shërbyer për ujitjen e tyre. Mirëpo më vonë paditësi në ngastrën e tij ka ndërtuar shtëpinë e banimit dhe pompen për shitjen e derivateve të naftës, kurse në ngastrat tjera janë ndërtuar objekte për banim, të cilën gjë së fundmi ka filluar ta bëjë edhe i padituri në pronën e tij. Nëse i referohemi periudhës kur është ndërtuar ky kanal (në të cilën janë vendosur gypat për sjellje të ujit) dhe qëllimit për të cilin ka shërbyer, me periudhën e tanishme, atëherë rezulton se ka dallime të mëdha. Në këtë përfundim gjykata arriti pas daljes në vend dhe vlerësimit të ekspertizave të ekspertëve përkatës, sidomos ekspertizës së fundit të ekspertit të hidrondërtimitarisë G. H., i cili në raportin e tij (por edhe sqarimet gojore të cilat i ka dhënë në shqyrtimin kryesor, ka sqaruar në detaje aspektet tekniko-teknologjike, më saktësisht dëmet të cilat i shkaktohen të paditurit nëse vazhdohet me vendosjen e gypave për sjelljen e ujit nëpër pronën e tij (pasi që gypat e vjetër kanë qenë të vendosura në mes të pronës së të paditurit apo nën themelet e shtëpisë së tij), duke sqaruar edhe mundësitë alternative të cilat i ka paditësi për të siguruar ujin për pronën e tij, pa kaluar fare nëpër pronën e të paditurit apo pa e dëmtuar të njëjtën. Gjykata vlerëson se pasja e servitutit sendor i mundëson pronarit përkatës të një paluajtshmërie (paluajtshmëria dominuese) që një paluajtshmëri tjetër (pasuria shërbyese) në një mënyrë të caktuar ta shfrytëzojë, mirëpo kjo duhet ti sigurojë ndonjë dobi titullarit të servitutit, përndryshe servituti është i palejuar. Gjithashtu titullari i të drejtës së servitutit sendor duhet ta ushtron servitutin në atë mënyrë, që pasurisë së paluajtshme ti paraqes ngarkesën më të vogël të mundshme, kurse gjatë

ushtrimit të një servituti, titullari i servitutit i ruan në mënyrë adekuate edhe interesat e pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar, derisa nuk cenohet ushtrimi i servitutit.

Nga provat e administruara gjykatës i rezultoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me Ligjin mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore për të vërtetuar se paditësi e ka të drejtën e servitutit të kalimit, ashtu siç është cekur në pikën **I** të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi në mënyrë substanciale kanë ndryshuar rrethanat në të cilat është lejuar shfrytëzimi i këtij servituti nga ana e të paditurit. Kjo për faktin se nga provat e administruara siç janë ekspertizat e ekspertëve të gjeodezisë dhe ndërtimtarisë, por edhe me vet daljen e gjykatës në vend, rezultoi se në momentin e krijimit të servitutit të kalimit kanë ekzistuar rrethana të tjera, ndërsa tani i padituri në trollin nëpër të cilin kanë kaluar gypat që kanë sjellur ujin në pronën e paditësit ka ndërtuar shtëpi banimi (është në proces të ndërtimit), ndërsa nga deklarimet e ekspertit të hidrondërtimtarisë të cilës gjykata ja fali besimin e plotë, rezulton se prurësi i ujit PCV Fi 100 mm duhet të dislokohet nga hapsirat e të paditurit, prurësi-gypi PVC Fi 100 mm i shtrirë nën objektin e të paditurit e destabilizon objektin tij në çdo pikëpamje, pasi që mund të ndodh rrjedhja e ujit nga lidhësat e gypave, apo të ketë ndonjë çrregullim tjetër eventual. Ndërsa ka sqaruar edhe mundësitë teknike të cilat i ka paditësi që të sigurojë ujin për pronën e vet pa pasur qasje fare në pronën e të paditurit dhe pa i shkaktuar kurrfarë dëmi të njëjtit (këto mundësi janë cekur më lartë, ndërsa është e drejta e paditësit që të zgjedhë mënyrën e sigurimit të ujit për pronën e vet). Si rrjedhojë, gjykata ka ardhur në përfundim se nuk mund të lejohet vërtetimi i servitutit të kalimit të ujit të cilin e kërkon paditësi, marr parasysh këtu rreziqet që i shkaktohen objektit familjar të të paditurit, si dhe duke marr parasysh mundësitë që i ka paditësi për të siguruar ujin për pronën e vet pa kaluar fare nëpër pronën e të paditurit dhe pa e dëmtuar atë (eksperti i ka sqaruar mundësitë teknike që i ka paditësi për të siguruar ujin për pronën e vet, ndërsa në shqyrtimin kryesor ka sqaruar se paditësi ujin për pronën e vet mund ta sigurojë edhe përmes pompave të ujit, pasi që lumi kalon përskaq shtëpisë së paditësit). Ndërsa deklarimet e ekspertit G. H. rrëzojnë pretendimet e paditësit të cekura në padi se të njëjtit duhet ti sigurohet vendosja e gypave nëpër pronën e të paditurit, pasi që i njëjti nuk ka alternativë tjetër apo kalim tjetër për të siguruar ujin për pronën e vet. Gjukata erdhi në përfundim se në këtë çështje nuk është e arsyeshme lejimi i kalimit me gypa për sjelljen e ujit nëpër pronën e të paditurit, pasi në rastin konkret dëmi që do të shkaktohej në sendin shërbyes (pronën e të paditurit), për shkak të lejimit të kalimit apo vendosjes së gypave për sjelljen e ujit, do të ishte më i madh se dobia e sendit dominant (pronës së paditësit).

Gjukata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale dhe ka shqyrtuar pretendimet e paditësit (gojore dhe atyre me shkrim), por ka ardhur në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në zgjidhjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Gjukata vendosi si në pikën **II** të dispozitivit të aktgjykimit, më saktësisht e shfuqizoi masën e përkohshme të sigurimit të caktuar me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr.651/12, datë 10.07.2012, pasi erdhi në përfundim se kanë pushuar së ekzistuari kushtet dhe rrethanat për të cilat gjykata e ka caktuar këtë masë dhe më nuk ka ndonjë rrezik që paditësi të pësojë ndonjë dëm të pariparueshëm,

ndërsa në anën tjetër me mbajtjen në fuqi të kësaj mase i padituri do të pësonte dëm të pariparueshëm, marr parasysh këtu faktin se i njëjti ka interes që të përfundoj objektin familjar të ndërtuar në truallin e tij dhe me këtë ti plotësojë nevojat e banimit të familjes së tij.

Në lidhje me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi konform nenit 452.1 të LPK-së dhe e obligoi paditësin që të paditurit t'i paguajë shumën prej 120 € dhe atë 100 € për ekspertizën e datës 09.07.2013 dhe 20 € për shpenzime të veturës së gjykatës për dalje në vend.

Andaj, bazuar në nenin 7, 8, lidhur me nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.651/12, dt. 25.07.2013

Procesmbajtësja,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.